

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L – 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës nr 28/2008, nenit 17 paragrafi 17.1 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, të Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013), dhe nenit 36 paragrafi 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01 – 013/491, të datës 21/04/2011 dhe mbështetur në kriteret e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë dhe të Kllokotit, të datës 28.12.2010, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.03.2016 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONA EKONOMIKE ME STATUSIN "PARKU INDUSTRIAL" NË FSHATIN BUDRIKË E EPËRME

I

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë LEJON që t'i qasemi hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishëm (në tekstin e mëtejme: (PRRH), të cilët do të përfshijnë hapësirën e planifikuar të zonës industriale sipas PZHK-së, e cila ndodhet në parcelën kadastrale P-70101012-00641-1, në vendin e quajtur "Batanica", me kulturë kullosë e klasës së tretë, me sipërfaqe prej 15.50,00ha, në zonën kadastrale të fshatit Budrikë e Epërme, në pronësi të Komunës së Vitisë.

II

Me PRRH-në nga pika 1 e këtij vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontest të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve ekonomike-industriale dhe destinime tjera sekondare si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje, përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional.

III

PRRH duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal.

IV


PRRH duhet të përmbajë pjesën tekstuale dhe pjesën grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara sipas Ligjit të Planifikimit Hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues të Hollësishëm.

V

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;



- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistiko-teknike dhe hapësinore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit Ekonomik, industrial etj;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përmbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbërimit, hapësirave të lira, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikes, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik.

VI

Bartës i hartimit të PRRH është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë.

VII

Projekti i PRRH duhet vënë në shqyrtim publik dhe komentim. Koha për shqyrtim publik dhe dhënien e komenteve duhet të shpallen në mjetet e informimit.

VIII

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të Komunës së Vitisë.

IX

PRRH do të hartohet për periudhën 5-8 vjeçare, në shtatë (7) kopje të origjinalit.

X

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës i Komunës së Vitisë dhe drejtoritë përkatëse.

XI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

Viti, më 29.03.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

